



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.44, datë 19. 06. 2018

Për

***“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a.
dhe Vodafone Albania sh.a.”***

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 19.06.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010 “Për proçedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a.
dhe Vodafone Albania sh.a.”***

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);

2. Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP;
4. Rregullore Nr.18, datë 11.06.2010 “Për proçedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”;
5. Rregullore Nr. 19 datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”;
6. Rregulloren nr. 35, datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e ALBtelecom sh.a., Nr 5437 Prot, datë 25.05.2018, “Mbi praktikën abuzive të përsëritur të "sim box-eve" të gjeneruara nga rrjeti i Vodafone Albania drejt rrjetit ALBtelecom”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., Nr 8882 Prot, datë 05.12.2017, “Mbi praktikën abuzive të përsëritur të "sim box-eve" të gjeneruara nga rrjeti i Vodafone Albania drejt rrjetit ALBtelecom”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., Nr 4190 Prot, datë 19.04.2016, “Mbi praktikën abuzive të "sim box-eve" të gjeneruara nga rrjeti i Vodafone Albania drejt rrjetit mobile dhe fiks të ALBtelecom”;
- Shkresa e Vodafone Albania sh.a., me Referencë LEA/109/OX, datë 15.12.2017, “Mbi tuajën nr.8882 prot datë5 Dhjetor 2017 ”;
- Shkresa e Vodafone Albania sh.a., me Referencë LRD/0065/OX, datë 27.04.2016, “Mbi tuajën nr.4190 prot datë 19 Prill 2016 ”.

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore dhe Drejtoria Juridike dhe e Integritimit, pasi morën në shqyrtim kërkesën e sipërmarrësit Altelecom Sha me shkresë nr. 5437 Prot, datë 25.05.2018 (nr.1715 Prot. i AKEP, datë 28.05.2018) “Mbi praktikën abuzive të përsëritur të “sim box-eve” të gjeneruara nga rrjeti i Vodafone Albania drejt rrjetit Altelecom”, si dhe materialin shkresor të përbërë nga :

- Shkresë e Albtelecom Sha nr. 5437 Prot, datë 25.05.2018 (nr.1715 Prot. i AKEP, datë 28.05.2018) “Mbi praktiken abuzive të përsëritur të “sim box-eve” të gjeneruara nga rrjeti i Vodafone Albania drejt rrjetit Albtelekom”.
- Bashkëngjitur është edhe një CD e cila përmban :
 - Komunikim elektronik (emaile) të skuadrës antifraud të AT drejtuar skuadrës antifraud të Vodafone (2016-2017-2018);
 - Korrespondenca elektronike (emaile) ndërmjet skuadrave respektive të menaxhereve të interkoneksionit (2016-2017-2018);
 - "File" të numrave (CLI-ve) të dedukuara nga teste të by-pass-it të thirrjeve/trafikut ndërkombëtar. (2016-2017-2018);
 - Përmbledhje e të gjithë trafikut nga këto CLI sipas muajve (2016-2017-2018).

Sipërmarrësi Albtecom sh.a. me shkresën nr. 5437 Prot, datë 25.05.2018, ka depozituar kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshjeje midis Albtelecom sh.a. dhe subjektit Vodafone Albania sh.a..

Në kërkesën e paraqitur, Albtelecom sh.a. është shprehur që i është drejtuar Vodafone Albania për këtë situatë me shkresat nr.4190 Prot., datë 19 Prill 2016 dhe shkresën nr.8882 Prot., dt.05.02.2017, por sipas Albtelecom në të dyja rastet Vodafone Albania nuk ka marrë asnjë veprim konkret për ndalimin e praktikës abuzive të SIM BOX-EVE.

Vodafone Albania në shkresat me referencë LRD/0065/OX (nr.821/1 Prot i AKEP dt. 27.04.2016) dhe LEA/109/OX (nr.2186/1 Prot i AKEP dt. 19.12.2017) pasi është informuar me shkresat e Albtelecom nr.4190 dt.19.04.2016 dhe nr.8882 dt. 05.12.2017, për pretendimet për pajisjet SIM-BOX shpreh mbështetjen maksimale për luftimin e ri-rrugëzimit të paligjshëm të thirrjeve, dhe fshehjen e CLI nga të tretët. Vodafone shprehet se nuk ka cënuar asnjë dispozitë të Marrëveshjes së Interkoneksionit mes palëve, apo akteve rregullatore në fuqi.

Albtelecom sh.a. informon se fenomeni i anashkalimit të trafikut ndërkombëtar nëpërmjet përdorimit të pajisjeve sim-box terminohet në rrjetin mobile apo edhe fiks të Albtelecom si trafik kombëtar, që prej muajit Janar 2016 e në vazhdim.

Albtelecom sh.a. shprehet në shkresë se në zbatim të Marrëveshjes së Interkoneksionit, nr. 3707 dt. 01.07.2013 ndërmjet Vodafone Albania sh.a. dhe Albtelecom sh.a, për shërbimet e rrjetit të telefonisë se lëvizshme, (Neni 18/pika 18.2 dhe Aneks V/ *Numeracioni dhe CLI*", neni 5.2 *"Identifikimi i Numrit Thirrës"*, pika 5.2.7 "), Vodafone ka detyrimin të verifikojë dhe të marrë masat për moslejimin e lidhjes në rrjetin e tij të ndonjë pajisje sim-box e cila mund të jetë subjekt i mos lejimit apo detyrimit për çertifikim edhe sipas legjislacionit shqiptar të sipërcituar.

Në komunikimet me email midis dy sipërmarrësve, Skuadra Antifraud Albtelecom informon skuadrën analoge të Vodafone për sjelljen e shumë numrave Vodafone që përdorin pajisjet SIM BOX. Skuadra Vodafone pasi i analizon këta numra nëse kane trafik të dyshimtë, ka marrë të gjitha masat për mbylljen e atyre numrave që kanë sjellje për përdorim SIM BOX.

Ne shkresë Albtelecom shprehet që Vodafone Albania jo vetëm që ka detyrimin për marrjen e masave paraprakisht për përjashtimin e rrugëzimit të thirrjeve përmes zgjidhjeve anashkaluese/periferike, por Vodafone Albania ka detyrimin për të ndërmarre edhe masa të menjëhershme për korrigjimin e situatës.

Gjithashtu Albtelecom shprehet që në zbatim të Marrëveshjes së Interkoneksionit në nenin 13 "Siguria e personelit dhe instalimeve/Ruajtja e Integritetit të Rrjetit", sipas së cilit në pikën 13.3 të tij parashikon se: "Asnjë nga palët nuk do të lidhë apo do të lejojë me dijeni interkonektimin në rrjetin e tij të ndonjë pajisje, aparati, përfshirë por jo vetëm, me ndonjë pajisje të terminimit që nuk është aprovuar, në përputhje kjo me Ligjin 9918, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.331, datë 14.4.2011.

Albtelecom shprehet që Vodafone Albania, implikon apo shkel direkt edhe detyrimet që lidhen me identifikimin e Numrit Thirrës, për të cilat Marrëveshja përmban dispozita të posaçme dhe parashikime përkatëse, bazuar në Neni 15 "Identifikimi i Numrit Thirrës", pika 15.2 ku parashikohet se "*Në momentin kur njëra Palë përcjell thirrjet në rrjetin e Palës tjetër, është e detyruar të transmetojë Identitetin e Numrit Thirrës, pa e ndryshuar ose fshehur atë*".

Marrëveshja e Interkoneksionit ka parashikime të qarta gjithashtu, mbi ndalimin e trafikut hyrës ndërkombëtar në rrjetin Albtelecom, konkretisht:

Neni 1 "Qëllimi dhe Fusha e Veprimit", pika 1.6 "*Kjo Marrëveshje nuk mbulon terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt pajtimtarëve/abonentëve të rrjetit Vodafone Albania dhe të rrjetit Albtelecom. Ky lloj shërbimi, do të trajtohet në marrëveshje të veçanta tregtare mes Vodafone Albania/Albtelecom dhe partnereve të saj, rast pas rasti*", dhe Aneks V "Numeracioni dhe CLI", neni 5.1 "Numeracioni", pika 5.1.4.2 "*Vodafone Albania nuk do të lejojë thirrje hyrëse ndërkombëtare, të rrugëzohen nga rrjeti i Vodafone Albania në rrjetin e Albtelecom nëpërmjet kapaciteteve që janë objekt i kësaj Marrëveshje të Interkoneksionit*".

Albtelecom në CD ka bashkëngjitur disa prova (raporte në Excel) për modifikimin e CLI për thirrjet e përcjella nga Vodafone Albania nëpërmjet praktikave abuzive apo të sim-box-eve dhe kërkohet që Vodafone Albania të ndërpresë menjëherë këto shkelje të konstatuara.

Albtelecom thekson se në zbatim të Nenit 5, pika 9, e Rregullores për Akses dhe Interkoneksion dhe pika 5.2.8 i Aneks V "Numeracioni dhe CLI" të Marrëveshjes së Interkoneksionit - 'Çdo ndryshim/modifikim apo fshehje të Identitetit të Numrit thirrës përben një shkelje të kushteve të marrëveshjes në fjalë si dhe një shkelje ligjore.

Albtelecom kërkon nga AKEP të detyrojë operatorin Vodafone Albania për marrjen e masave konkrete për ndalimin e menjëhershëm dhe bllokimin e këtij lloj trafiku dhe marrjen e masave për parandalimin e përsëritjes së rasteve të ngjashme në të ardhmen.

Në të njëjtën kohë, kërkohet që operatori Vodafone Albania duhet të kompesojë dëmin e shkaktuar të trafikut në shkelje, për të gjitha CLI-të e njoftuara palës Vodafone si "praktika sim-box-i", trafiku i realizuar nga këto CLI drejt rrjetit Albtelecom, për periudhën që nga Janari 2016 e në vijim dhe për ta faturuar sipas natyrës reale të këtij trafiku, - trafik ndërkombëtar.

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore dhe Drejtoria Juridike, pasi shqyrtuan dokumentacionin sipërcituar, gjykojnë se "Kërkesa për zgjidhje mosmarrëveshje" nga ana e Albtelecom është paraqitur sipas kushteve formale-juridike të parashikuara në Rregulloren nr.18, datë 11.06.2010 "Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve".

Gjithashtu objekti i mosmarrëveshjes, për të cilin AKEP është investuar, është brenda kompetencës lëndore të tij sipas parashikimeve në Rregulloren nr.18, datë 11.06.2010 "Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve", Rregulloren nr.19, date 14.06.2010 për "Aksesin

dhe Interkoneksion” dhe Rregulloren nr. 35, datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Duke qenë se sipërmarrësit Albtelecom Sha dhe Vodafone Albania megjithë përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis tyre, në zbatim të nenit 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, AKEP zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 114, neni 115 si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015) neni 130 e në vijim,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.;
2. Të ngrihet Komisioni për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes sipas procedurës dhe afatave të përcaktuara në Rregulloren 18 të datës 11.6.2010.
3. Të njoftohen palët e interesuara Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir Zela

ANËTARË:

1. Z. Alban	Karapici	Anëtar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
4. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar